

GËZUAR 100 VJETORI, I PAVDEKSHMI ENVER HOXHA!



Mbrëmë në Sallën e Kuqe në Prishtinë, organizuar nga Klubi Politik "Afrim Zhitia", u mbajt një manifestim me rastin e 100 vjetorit të lindjes së kolosit të kombit tonë, të pavdekshmit Enver Hoxha!

Kosova martire nuk të ka harruar, përkundrazi, të mbanë ngrohtë në gji! Këtë e dëshmuar mbrëmë në Prishtinë, duke kujtuar ditëlindjen Tënde të 100-të, dhe duke uruar t'i bësh dhe 1000 të tjera! Pavarësisht thirrjes hysterike të Sali Berishës, këtij bastardi të kombit tonë, për të bojkotuar manifestimet e paralajmëruara me rastin e 100 vjetorit të lindjes së njëres nga figurat më të shkëlqyera të kombit tonë, Enver Hoxhës, djemtë e vajzat kosovare dëgjuan thirrjen e zemrës e të shpirtit dhe ia mësyar dyerve të Sallës së Kuqe në Prishtinë. Salla ishte e vogël për të pranuar të interesuarit e shumë.

Në sallë binin në sy sidomos aktivistë e veprimtarë të viteve të 70-ta dhe 80-ta, ajo gjeneratë e cila barti mbi supë barrën e rëndë të kohës, luftën për liri e pavarësi. Armë kryesore në këtë luftë ata kishin mësimet e shëndosha dhe të çmueshme të bac Enverit, pa të cilat sot në Kosovë ndoshta as nuk do të flitej shqip.

Në mesin e pjesëmarrësve të shumë ishin edhe Ilir Hoxha, djali i madh i Enver Hoxhës, si dhe Ramiz Alia, njëri nga bashkëpunëtorët e Enver Hoxhës.

Që në fillim ky manifestim ishte edhe si një testim shpirti për kosovarët, ku djemtë e Kosovës para kamerave televizive treguan edhe se sa e "donë" të ashtuquajturin "Flamur" dhe "Himn të Kosovës"! - duke i fishkëlluar!